



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 76/ Prot.

Tiranë, më 04.03.2020

PROCESVERBAL

Sot, më datën 04.03.2020, ditë e mërkurë, ora 11.00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, u mbajt mbledhja plenare e radhës e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, thirrur nga Kryetari, bazuar në nenet 164 deri në 167 të Ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Këshilli mblidhet në prani të anëtarëve si më poshtë:

1. Gent Ibrahimi
2. Alfred Balla
3. Nurihan Seiti
4. Tartar Bazaj
5. Bujar Sheshi
6. Kosta Beluri
7. Sandër Beci
8. Esmeralda Keshi
9. Vatë Staka

Nuk është i pranishëm z. Dollapaj.

Nga administrata e KLP janë të pranishëm:

- Sekretari i Përgjithshëm
- Drejtori i Kabinetit

Mbledhja u zhvillua nën drejtimin e Kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, z. Gent Ibrahimi, i cili në zbatim të nenit 166 të Ligjit Nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të



Drejtësisë”, i ndryshuar, pasi verifikoi pjesëmarrjen e anëtarëve dhe kuorumin, bëri hapjen e saj në kushtet e kuorunit dhe kaloi në prezantimin e rendit të ditës:

Rendi i Ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes plenare të datës 24.02.2020 të Këshillit.
2. Miratimi i projektaktit për komandimin e magjistrates Mirela Kapo, ndihmësmagjistrate pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
3. Miratimi i projektaktit për mbarimin e mandatit të z. Besnik Cani, si anëtar i KLP-së.
4. Hedhja e shortit për përzgjedhjen e tre anëtarëve të komisionit të përkohshëm, që do të shqyrtojë ankimin e një shtetasi kunder vendimit të Prokurorit të Përgjithshëm, i cili ka vendosur arkivimin e çështjes.
5. Të tjera (pyetje, përgjigje, diskutime).

Z. Ibrahim pyet nëse ka pyetje dhe komente.

Më pas, Kryetari parashtron propozimin e paraqitur nga dy anëtarë të KLP-së, për përfshirjen në rendin e ditës të çështjeve shtesë si më poshtë:

1. **Z. Beluri** propozon në emër të Komisionit për Vlerësimin e Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, përfshirjen në rend të ditës të një shtese, në vendimin nr.56 dt.24.02.2020 të Këshillit “Për kryerjen e verifikimit të figurës dhe pasurisë për kancelarët në detyrë”. Ai citon pikën 1, nenin 111 të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë”, tek dispozitat kalimtare për Sekretarin e Përgjithshëm dhe kancelarin, ku thuhet se: Këshilli i Lartë i Prokurorisë, brenda katër muajve nga krijimi i tij, kryen verifikimin e figurës dhe të pasurisë, si dhe plotësimin e kushteve dhe procedurave të parashikuara nga ligji për shërbimin civil për sekretarin e përgjithshëm dhe kancelarët në detyrë. Propozon: Ndryshimin e pikës 1 të vendimit “Të kryejë verifikimin e figurës dhe pasurisë për kancelarët në detyrë”, me togfjalëshin: “Të kryejë verifikimin e figurës dhe pasurisë dhe kritereve të tjera ligjore për kancelarët në detyrë” si dhe ndryshimin e pikës 2 të vendimit nr. 56, dt. 24.02.2020, “Të hartojë raporte të veçanta me rezultatet e verifikimit për çdo kancelar në detyrë”, me togfjalëshin: “Të hartojë raporte të veçanta me rezultatet e verifikimit për çdo kancelar në detyrë, sipas pikës 1 të këtij vendimi”.

Z. Ibrahim hedh në votim përfshirjen e kësaj pike në rendin e ditës dhe miratimin e kësaj shtese.

Miratohet me 9 vota pro.



2. **Z. Sheshi** propozon që të bëhet një ndryshim në Rregulloren e Këshillit për Caktimin e Përkohshëm, dt.15.04.2019, lidhur me kufizimin që kjo Rregullore, përcakton në nenin 3, pikën 3 të saj: “Këshilli nuk mund të caktojë përkohësisht një prokuror më shumë se katër herë në të njëjtin pozicion ose në një pozicion tjetër”, ndërkohë që neni 59 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, nuk përcakton afatin kohor. (Pika 8: Kur një pozicion është përkohësisht i lirë, ai mund të plotësohet vetëm përmes caktimit të përkohshëm të magjistratit.....).
3. **Z. Sheshi** i kujton Këshillit situatën me të cilën u përball Këshilli në rastin e Prokurorisë së Gjykatës së Apelit Korçë. Në këto kushte, e shikon të nevojshme heqjen e kufizimit të sipërcituar.

Z. Ibrahimi hedh në votim përfshirjen e kësaj pike në rend të ditës.

Miratohet me 6 vota pro. Kundër znj. Keshi, z.Staka dhe z. Beci.

Z.Ibrahimi vijon me pikën e parë të rendit të ditës.

- *Miratimin e procesverbalit të mbledhjes plenare të datës 24.02.2020 të Këshillit.*

Z.Ibrahimi vijon me pikën e dytë të rendit të ditës.

- *Miratimin e projektaktit për komandimin e magistrates Mirela Kapo, ndihmësmagjistrate pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.*

Z. Ibrahimi i jep fjalën z. Staka të relatojë në emër të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës.

Z. Staka lexon relacionin që ka përgatitur ky komision për komandimin e znj. Mirela Kapo, në pozicionin e sipërcituar. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në nenet 53, paragrafi 2, 54, 55 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, i ndryshuar, më dt 01.02.2020, shpalli hapjen e procedurës për paraqitjen e kërkesave që vijnë nga rradhët e prokurorëve për t’u komanduar me pëlqimin e tyre, për magjistrat pranë zyrës së ILD –së. Afati i paraqitjes së kërkesave është parashikuar 2 javë nga dita e shpalljes së vendimit në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Brenda këtij afati, janë paraqitur dy kërkesa ,e znj. Mirela Kapo dhe e z. Julian Zonja. Komisioni, mbështetur në nenin 54/4 të ligjit të sipërcituar, përgatit një projekt opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e larta të prokurorisë ku prokurori ushtron funksionin. Në rastin e znj.Mirela Kapo, rezulton se, nisur nga ngarkesa e saj në punë, komandimi i saj nuk çënon funksionimin e prokurorisë, e konfirmuar dhe nga kthim përgjigja e Drejtuesit të kësaj prokurorie dhe nuk ka masa disiplinore, ndërkohë bazuar në kthim përgjigjen e ardhur nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, ku argumenton se, për shkak të ngarkesës së madhe në punë, komandimi i z. Zonja, do të dëmtonte



interesat aktuale të prokurorisë në fjalë .Sa më sipër, Këshilli miratojë lejimin e vijimit të procedurës së komandimit për znj. Kapo. Në përgjigje të shkresës së KLP drejtuar ILD, Drejtuesi i ILD-së z. Metani, i kërkon Këshillit komandimin e znj. Mirela Kapo pranë kësaj zyre për një periudhë pesë vjeçare.

Z. Ibrahim falenderon z. Staka për relatimin dhe lexon vendimin. Mbështetur në nenin 149/a të Kushtetutës së Shqipërisë, nenet 53/2, 54, 55, të ligjit nr.96/2016 “ Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, si dhe në nenet 164/8, 166/2, 189/1/ a, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshur, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, vendosi:

1. Komandimin e znj. Mirela Kapo, prokuror pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë, në pozicionin e ndihmësmagjistratit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
2. Periudha e komandimit do të jetë 5 (pesë) vjet dhe fillon nga data 04.03.2020.
3. Të njoftohen për këtë vendim, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe znj. Mirela Kapo.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

Z. Ibrahim hedh në votim miratimin e projektaktit.

Miratohet me 9 vota pro.

Z.Ibrahim vijon me pikën e tretë të rendit të ditës.

- *Miratimin e projektaktit për mbarimin e mandatit si anëtar i KLP-së për z. Besnik Cani.*

Z. Ibrahim pyet nëse ka pyetje dhe komente.

Z. Ibrahim i kalon fjalën z. Beci i cili kërkoj fjalën.

Z. Beci shprehet se, është dyshues për faktin nëse është kompetencë e Këshillit që të shprehet lidhur me vendimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për shkarkimin e z.Cani. Ai i kujton Këshillit dhe situatën e ngjashme të ish-anëtarëve të mëparshëm: Znj. Antoneta Sevdari dhe z. Gentjan Osmani. Prezanton një qasje tjetër lidhur me këtë çështje. Sqaron se, krijimi për herë të parë i KLP është rregulluar me dispozitën kalimtare të ligjit nr. 115/2016 të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Citon dispozitën kalimtare, nenin 279 të ligjit të sipërcituar ku parashikohet zgjedhja e anëtarëve të KLP-së, nenin 108, 109, 280 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Bën me dije se, ligji për anëtarët e parë të Këshillave, ka parashikuar vetëgjykim në shkallë të parë dhe aty do të konsiderohej i përfunduar ky proces. Pyetja që shtrohet është nëse do të shtrijë efektet vendimi i KPA -së ndaj anëtarit të KLP-së që vjen nga rradhët e prokurorisë, apo ky vendim prodhon pasoja vetëm në momentin kur, në rastin konkret, z. Cani përfundon në mënyrë të natyrshme mandatin dhe i lind e drejta për tu rikthyer në detyrën e



prokurorit. Sipas nenit 179/b të Kushtetutës parashikohet që rivlerësimi do të kryhet mbi bazën e parimit të rivlerësimit të rregullt si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjektit të vlerësimit. Të gjithë prokurorët dhe ndihmësit i nënshtrohen vlerësimit Ex officio. Z. Beci shprehet se, në kuptim të dispozitës kushtetuese për procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, rezulton qartë se procesi i rivlerësimit nuk vepron mbi anëtarët e KLP apo KLGJ. Pavarësisht kësaj, KPA ka marrë një vendim për të cilin Këshilli duhet të diskutojë nëse sjell pasoja të menjëhershme juridike mbi statusin e z. Cani apo jo. Analizon format e përfundimit të mandatit kushtetues, sipas nenit 149/b/c/ç të Kushtetutës. Z. Beci argumenton se, asnjë prej këtyre kushteve nuk plotësohet në rastin e z. Cani. Në momentin e kandidimit z. Cani nuk ka pasur asnjë kusht pajzgjidhshmërie (neni 105 i ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”). Vendimi i KPA-së nuk prodhon asnjë efekt apo pasojë juridike mbi mandatin kushtetues si anëtar i KLP-së, ky vendim i sjell efektet vetëm pas përfundimit të mandatit 5 vjeçar, kur z. Cani i lind e drejta e rikthimit në detyrën e prokurorit. Këshilli i Lartë i Prokurorisë është në pamundësi juridike të deklarojë përfundimin e mandatit të z. Besnik Cani, pasi nuk ndodhet në asnjë nga kushtet e përcaktuara nga Kushtetuta, në nenin 149/b të saj.

Z. Ibrahim pyet nëse ka pyetje dhe komente.

Rreth kësaj çështje u diskutua:

Z. Ibrahim i kalon fjalën znj. Seiti.

Znj. Seiti shprehet se, nëse Këshilli e shikon të arsyeshme, duhet që të marrin pak kohë për tu shprehur, gjithësesi vlerëson që do të ishte një proces i vështirë, pasi do ti duhet që të ballafaqohet me ligjin, praktikën. Gjithsesi do të jetë shumë e vështirë për shkak të largimit të mëparshëm të dy anëtarëve nga KLP-ja.

Z. Bazaj shprehet se është dakord me interpretimin e z. Beci. Por gjendemi në kushtet e mungesës së Gjykatës Kushtetuese e cila duhet të bënte interpretimin e vendimit të KPA-së, sepse realisht ky vendim nuk sjell pasoja juridike për mandatin që ka, pasi z. Cani është në një pozicion tjetër, jo prokuror. Në këto kushte, ai shprehet se në vendimmarrje është pro projektaktit të propozuar, me argumentin se tashmë Këshilli ka një praktikë.

Z. Staka bën me dije, se u njoh me këtë propozim vetëm në këtë mbedhje plenare. Propozon që, për të qënë sa më objektiv, Këshillit t’i lihet një afat kohor për t’u konsultuar dhe me praktika të tjera.

Z. Beluri shprehet se, ashtu si dhe për dy ish-kolegët e mëparshëm, edhe për kolegun Cani, Këshilli duhet të mbajë të njëjtin qëndrim. Vlerëson që KPA konsiderohet Gjykatë Kushtetuese dhe procesi që zhvillohet për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve është një proces disiplinor. Ky kolegji ka konstatuar shkelje disiplinore dhe, në referencë të nenit 149/b të Kushtetutës, Këshilli duhet t’i



konsiderojë si të tilla. Në këto kushte, Këshilli është i detyruar të shprehet për mbarimin e këtij mandati.

Z. Balla shprehet se KPA është organi më i lartë në rastet e procedurave administrative për shkeljet disiplinore dhe konsiderohet si Gjykatë Kushtetuese (lexon vendimin e KPA-së). Bën me dije se dhe z. Cani i ka kërkuar KPA-së pezullimin e çështjes me të njëjtin interpretim, siç u shpreh dhe z. Beci. Mbështetur në nenin 149/b/1, pika d e Kushtetutës. jemi në kushtet e papajtueshmërisë. Ai sqaron se papajtueshmëria mund të lindë edhe gjatë kohës kur një prokuror është anëtar i Këshillit. Në këto kushte, propozon që, si në rastin e dy ish-anëtarëve të tjerë, Këshilli të shprehet për përfundimin e mandatit edhe pse formalisht, pasi vendimi i KPA-së është me efekt të menjëhershëm dhe përfundimtar.

Z. Ibrahim sqaron se, nëse ky diskutim do të ishte ngritur që në rastin e dy ish-anëtarëve, kur Këshilli u ballafaqua me situata të tilla, qëndrimi që do të mbante Këshilli mund të ishte dhe i ndryshëm. Gjithësesi, Këshilli për dy rastet e mësipërme, ka bërë një interpretim të ligjit dhe ka arritur në konkluzionin që: KPA është Gjykatë Kushtetuese dhe si e tillë ka juridiksion disiplinor mbi anëtarët e Këshillit, dhe se papajtueshmëria lind edhe kur mungon kushti bazë për të qënë anëtar i Këshillit, i cili në rastin e anëtarëve prokurorë, është pikërisht të qënit prokuror. Z. Ibrahim është dakord me propozimin e ardhur nga Komisioni i Disiplinës dhe ia kalon Këshillit për votim.

Z. Ibrahim lexon vendimin. Bazuar në nenin 149/b pika 1, germa “d” e Kushtetutës, në nenin 66/3 të ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve” në Republikën e Shqipërisë, si dhe në nenet 164/8, 166/2, 189/ 1 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, pasi u njoh me vendimin e KPA-së dhe relacionin e përgatitur nga Komisioni i Disiplinës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, vendosi:

1. Të deklarojë mbarimin e mandatit si anëtar i KLP-së, për z. Besnik Cani, për shkak të papajtueshmërisë në ushtrimin e detyrës.
2. Të njoftohet me këtë vendim z. Besnik Cani.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit.

Z. Ibrahim hedh në votim miratimin e projektaktit.

Miratohet me 7 vota pro. Kundër z. Beci dhe z. Staka.

Z. Ibrahim vijon me pikën e katërt të rendit të ditës.

- *Hedhjen e shortit për përzgjedhjen e tre anëtarëve të komisionit të përkohshëm i cili do të shqyrtojë ankimin e një shtetasi kundër vendimit të Prokurorit të Përgjithshëm i cili ka vendosur arshivimin e çështjes.*



Z. Ibrahim i kalon fjalën z. Sheshi për të relatuar në emër të Komisionit të Disiplinës.

Z. Sheshi relatton rastin e një shtetasi, i cili ka paraqitur një kërkesë/ankesë pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, duke kërkuar fillimin e hetimit disiplinor kundër një prokurori. Këtë kërkesë/ankesë ia ka dërguar edhe Prokurorit të Përgjithshëm.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, në bazë të nenit 160, pika 5 e ligjit nr.96/2016, me shkresën nr.324/1, datë 03.10.2019 e ka përcjellë këtë ankesë për trajtim dhe kompetencë në Prokurorinë e Përgjithshme. Me vendim nr 18/1, datë 24.01.2020, Prokurori i Përgjithshëm ka vendosur arkivimin e kësaj kërkesë/ankese.

Kundër këtij vendimi, mbështetur në nenin 121/3 të ligjit nr. 96/2016 “Mbi statusin e gjyqtarëve dhe prokurorisë” në Republikën e Shqipërisë, është ushtruar ankim nga ana e qytetarit, përpara KLP-së.

Bazuar në nenin 160, pika 13 e ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, për shqyrtimin e kësaj ankese krijohet një komision i përkohshëm i përbërë nga 2 anëtarë joprokurorë dhe 1 anëtar prokuror. Përbërja e këtij komisioni përcaktohet me short nën kujdesin e Kryetarit të Këshillit. Vendimet e këtij komisioni janë përfundimtare dhe nuk mund të apelojnë para mbledhjes plenare të Këshillit.

Z. Ibrahim pyet nëse ka pyetje dhe komente.

Rreth kësaj çështje u diskutua:

Z. Sheshi bën me dije që, Këshilli nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, me argumentin që Këshilli vetëm do ta shqyrtojë këtë kërkesë/ankesë, dhe nuk merr vendim. Komisioni vendos, nëse do të pranohet ky ankim ose jo, apo nëse do të bëjë shfuqizimin e vendimit për arkivim dhe kthimin e çështjes për hetim dhe procedim disiplinor të mëtejshëm. Ai thekson se, komisioni nuk do të shqyrtojë çështjen, por vetëm ankesën ndaj vendimmarrjes për arkivim.

Z. Balla shprehet se e shikon si problem në të ardhmen. Nëse vendimi i KLP-së do të jetë për shfuqizimin dhe kthimin e çështjes pranë ILD dhe Inspektori vjen me një mendim ndryshe, anëtarët e komisionit të përkohshëm më sipër mund të kenë konflikt interesi në trajtimin, në qoftë se ky rast do të vijë për masë disiplinore në Këshill.

Z. Sheshi sqaron se, qëndrimi i këtij komisioni është thjesht për bazueshmërinë ligjore të aktit që merr drejtuesi, në rastin konkret ILD, nëse vendos për arshivimin e kërkesë/ankesës. Nuk ka konflikt interesi, pasi Këshilli e trajton çështjen në aspektin procedural dhe jo lëndor.

Z. Ibrahim ndan të njëjtin mendim si z. Sheshi. Nëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë ose Prokurori i Përgjithshëm, në rastin konkret, vendos që të arkivojë një ankesë, arsyet që e kanë çuar Prokurorin e Përgjithshëm të marrë këtë vendim janë: ankesës i mungojnë ekstremitetet, emri i ankuesit ose



ankimi ka të bëjë me çështje që nuk janë në listën e çështjeve disiplinore, pra janë çështje formale që nuk kanë të bëjnë me thelbin e ankimit, i cili në këtë rast hetohet nga ILD dhe vendoset që të parashtrahet si një çështje disiplinore para Këshillit. Kjo do të trajtohet në thelb kur të jetë momenti dhe vendimi që mund të këtë marrë Komisioni i përkohshëm në lidhje me pranueshmërinë ose jo të ankesës, është i tillë që nuk do të cënojë paanshmërinë e Këshillit kur të gjykojë për thelbin e këtij ankimi.

Z. Ibrahim më pas vijon me procedurën e shortit.

Shorti zhvillohet në dy faza: në fazën e parë u përzgjedhën nga radhët e anëtarëve jo prokurorë, ndërsa në fazën e dytë, nga radhët e anëtarëve prokurorë të Këshillit. Në përfundim të shortit, u zgjedhën z. Bazaj dhe z. Balla, nga anëtarët jo prokurorë dhe z. Beluri, nga rradhët e anëtarëve prokurorë.

Z. Ibrahim shprehet se Komisioni do të fillojë punën, sapo të zgjidhet Kryetari i tij.

Z. Ibrahim vijon me pikën që u përfshi në rendin e ditës.

➤ *Miratimi i një ndryshimi në Rregulloren e Këshillit për Caktimin e Përkohshëm*

Z. Ibrahim lexon Vendimin nr. 64 i dt.15/04/2019 të “Rregullores për Caktimin e Përkohshëm të Prokurorëve”. Në mbështetje të nenit 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 59 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” i ndryshuar, nenit 164 dhe 189 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, vendosi:

1. Të shfuqizojë pikën 3 të nenit 3 të Rregullores për Caktimin e Përkohshëm të Prokurorëve.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Z. Ibrahim pyet nëse ka pyetje dhe komente.

Rreth kësaj çështje u diskutua:

Z. Beci shprehet se, kur të përfundojë Rregullorja për ngritjen në detyrë dhe ajo për lëvizjen paralele, Këshilli duhet të ketë një qasje edhe ndaj Rregullores për Caktimin e Përkohshëm të Prokurorëve, dhe kjo dot ta sjellë Këshillin në kushtet reale. Në momentin kur është hartuar kjo Rregullore, Këshilli ka marrë parasysh dhe afatet që angazhojnë institute të ndryshme të parashikuara në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”. Këshilli ka caktuar një afat 1- vjeçar, duke u nisur nga logjika që, nëse do të ishte mbi afatin 1-vjeçar, atëherë do të ishim në kushtet e transferimit.

Ai shprehet dakord që të bëhet ky ndryshim, në kushtet aktuale, kur Këshilli operon pa këto dy rregullore, por thotë se, në momentin kur të hartohen këto rregullore, Këshilli duhet ta rimodifikojë



përsëri Rregulloren për Caktimin e Përkohshëm, me argumentin se kjo rregullore do të vazhdojë të funksionojë. Mendon që dy rregulloret e reja nuk e shfuqizojnë dhe as e rregullojnë situatën, siç e rregullon Rregullorja për Caktimin e Përkohshëm për rastet emergjente, të cilat mund të lindin në çdo kohë.

Z. Ibrahim është dakord me propozimin e z. Beci dhe shton se, në momentin kur të hartohen dy rregulloret përkatëse, nuk do të jetë më e nevojshme përdorimi i kësaj rregulloreje. Ndryshimet e nevojshme duhen bërë kur të vijë momenti i duhur.

Z. Balla shtron pyetjen nëse do të ishte ende e domosdoshme që Këshilli të përdorë Rregulloren për Caktimin e Përkohshëm?

Znj. Seiti sqaron se, do të jetë nevoja e përdorimit të kësaj rregulloreje, por ne duhet të sqarojmë nëse do të bëjmë një ndryshim të përhershëm apo po e ndryshojmë sepse ndodhemi në këtë situatë.

Znj. Keshi sqaron votën e saj kundër propozimit për ndryshimin e Rregullores për Caktimin e Përkohshëm të Prokurorëve dhe shprehet se, kjo rregullore është ndër rregulloret më problematike që ka hartuar Këshilli. Ajo thotë se, caktimi i përkohshëm është një mekanizëm joefektiv, i cili nuk përdor asnjë kriter nga ato që janë parashikuar në Rregullore; asnjë standard si zgjidhen kandidatët dhe si propozohen në Këshill. Ajo citon pjesën 3 deri 7 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”. Ligji është i qartë dhe i ka dhënë mekanizmat për çdo hapësirë që krijohet nga vendet vakante. Nuk ka një procedurë se si i drejtohet anëtari i Këshillit, Komisionit për Zhvillimin e Karrierës, arsyet e përzgjedhjes së kandidatëve. Në këtë mënyrë, ne i kemi shndërruar magistratët nga të pavarur në të varur.

Z. Sheshi shprehet se, kjo rregullore mund të ketë nevojë për ndërhyrje. Është dakord me një pjesë të verejtjeve të znj. Keshi. Sqaron se, duhet të merret parasysh fakti që Këshilli e ka hartuar atë për të qenë e përkohshme dhe në kushtet e emergjencës. Këshilli ka qënë i detyruar ta hartonte këtë rregullore, sidomos lidhur për caktimin e vendeve të përkohshme, kryesisht për rastet e drejtuesve të prokurorisë (procesi i vetingut). Nuk është dakord me kundërshtimin që znj. Keshi shprehu për pikën 3.

Znj. Seiti është dakord me znj. Keshi që Rregullorja ka nevojë për ndryshime, por sqaron se, Këshilli ka marrë vendime në kushte emergjente dhe, kësaj, ka qënë i detyruar t'i referohej caktimit të përkohshëm. Thekson që Këshilli në çdo rast ka patur parasysh çdo element që ka të bëjë me përmbushjen e kushteve ligjore, etike dhe disiplinore. Kujton rastin e Drejtuesit të Elbasanit, ku Këshillit iu desh kohë për ta shqyrtuar dosjen dhe mori kohë për vendimarrje.

Z. Staka shprehet kundër ndryshimit të kësaj rregulloreje. Kujton mbarimin e mandatit të prokurores së prokurorisë së Korçës, gjë që, në opinionin e prokurorëve, nuk sjell diçka pozitive dhe ata nuk do ta mirëkuptonin këtë ndryshim.



Z. Balla shprehet se, ai e ka propozuar ndryshimin e kësaj rregulloreje, edhe në mbledhjet informale. Ai sqaron që Këshilli, në të gjitha rastet e caktimeve të përkohshme, ka zhvilluar një procedurë ligjore të rregullt, mbështetur në kriteret ligjore, pa cënuar integritetin e magjistratëve, madje Këshilli ka zgjedhur më të mirët nga radhët e tyre.

Z. Bazaj kundërshton z. Balla dhe shprehet se, Këshilli nuk ka zgjedhur magjistratët më të mirë, pasi të gjithë janë të mirë. Është dakord me propozimin e z. Sheshi.

Z. Ibrahim hedh në votim miratimin e projektvendimit.

Miratohet me 7 vota pro. Kundër znj. Keshi dhe z. Staka.

Në përfundim, duke mos patur pika të tjera për diskutim, Kryetari e deklaroi mbledhjen të mbyllur.

Mbajtësi i procesverbalit

(Sonila Çeliku)

KRYETARI

Gent Ibrahim



Shënim: Shënimi i mëposhtëm vendoset pas përfundimit të të gjithë procedurave të rishikimit.

Lidhur me këtë procesverbal, janë/nuk janë vënë në dukje pasaktësi nga anëtarët e KLP-së. Pasaktësitë e vërejtura janë reflektuar me urdhër të Kryetarit, Nr. ___ Datë ___ 2020/me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë Nr. ___ datë ___ (bashkëngjitur kopjet e dokumenteve). Procesverbali i mësipërm u miratua në mbledhjen e radhës të KLP-së, datë ___ / ___ /2020
Procesverbali të arkivohet.

PËRGJEGJËSI I SEKTORIT TË SHËRBIMEVE ADMINISTRATIVE

Frederik Sulisufi